



# Daconil® 720 SC

**Lënda vepruese:** Chlorothalonil  
**PËRMBAJTJA:** Chlorothalonil: 72%  
 Lëndë ndihmëse: 28%  
**Numri i regjistrimit:** AL: 33/2-08.10.2010  
 KS: 093-0743-11-2007/06.03.2007  
**Formulimi:** Suspension i koncentruar

## FUNGICID ORGANIK ME VEPRIM PARAMBROJTËS

### PËRDORIMI:

KULTURAT BUJQËSORE	SËMUNDJET	Doza ml/100 l ujë
<b>PERIME BIMË TË ARAVE</b>	Vrugjet ( <i>Pseudoperonospora cubensis</i> & <i>Phytophthora</i> spp. & <i>Peronospora</i> spp. & <i>Bremia lactucae</i> ) Kladosporiozat ( <i>Cladosporium</i> spp.) Alternariozat ( <i>Alternaria</i> spp.) Antraknozot ( <i>Colletotrichum</i> spp. & <i>Ascochyta pisi</i> ) Cerkosporiozat ( <i>Cercospora</i> spp.) Kalbëzimet ( <i>Botrytis</i> spp. & <i>Sclerotinia sclerotiorum</i> ) Kroma e zezë ( <i>Rhizoctonia solani</i> ) Septoriozat ( <i>Septoria</i> spp.) <i>Phomopsis</i> spp. <i>Diaporthe Phaseolorum</i> <i>Stemphylium solani</i>	150-200 250-300 250-300 200-250 250-300 200-250 250-300 200-250 200-250 200-250 200-250
<b>DRITHËRA</b>	Helmintosporiozat ( <i>Helminthosporium tritici</i> & <i>H.turcicum</i> & <i>H.oryzae</i> & <i>H.sativum</i> & <i>H.sigmoideum</i> ), Kalbëzimi i qafës së kërcellit ( <i>Pseudocercospora herpotrichoides</i> ), Cerkosporioza ( <i>Cercospora oryzae</i> ), Kroma e zezë ( <i>Rhizoctonia solani</i> ), <i>Rhynchosporium secalis</i> , <i>Septoria nodorum</i> , <i>Entyloma oryzae</i>	150-200
<b>LULESHTRYDHE</b>	Njollozja e gjetheve ( <i>Mycosphaerella fragaria</i> ), Vrugjet ( <i>Peronospora fragaria</i> & <i>Phytophthora omnivora</i> ), Kalbëzimi gri ( <i>Botrytis cinerea</i> ), <i>Dendrophoma obscurans</i> , <i>Diplocarpon earliana</i>	200
<b>HARDHI</b>	Vrugu ( <i>Plasmopara viticola</i> ) Kalbëzimi gri i rrushit ( <i>Botrytis cinerea</i> ), Kalbëzimi i zi i rrushit ( <i>Guignardia bidwellii</i> ), Antraknoza e hardhisë ( <i>Elsinoe ampelina</i> )	170-230 250-300
<b>PEMË FRUTURE</b>	Kalbëzimet e frutave ( <i>Monilia laxa</i> & <i>M.fructigena</i> ), Gjethebiruesja e bërthamoreve ( <i>Coryneum beyerinckii</i> ), Gjethepërdredhësja e pjeshkës ( <i>Taphrina deformans</i> ), Kalbëzimi i hirtë ( <i>Botrytis cinerea</i> ), Kromat ( <i>Venturia inaequalis</i> & <i>V.pirina</i> & <i>Fusicladium eriobotial</i> & <i>Elsinoe Fawcetti</i> ), Njollozja e bardhë e gjetheve ( <i>Septoria pyricola</i> ), Kladosporioza ( <i>Cladosporium carpophilum</i> ), Melanoza ( <i>Diaporthe citri</i> ), <i>Tranzschelia discolor</i>	150-200

**MËNYRA E TRAJTIMIT:** Spërkatje parambrojtëse që përsëriten çdo 10-14 ditë në vartësi të infeksionit. Norma e ujit për ha lëviz 400-1400 litra në vartësi të kulturave për të siguruar një lagje të mirë të masës bimore.

**FITOTOKSICITETI:** Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme. Të evitohet përdorimi pas lidhjes së frutave në kultivarët e hardhisë për rrush tryeze dhe pas fillimit të pjekjes së frutave të shalqinit.

**PËRZIHET** me shumicën e pesticideve. Nuk përziehet me lëngjet ngjitëse, me preparate shumë bazike, me hidroksid bakri dhe me ato që përmbajnë azinphos ose methidathion.

**SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:** 7-10 ditë.

**PERIUDHA E RUAJTJES:** 3 vjet. Ruajeni në ambalazhin origjinal, në vende të thata e të ajrosura.

### MASAT PARAMBROJTËSE

-Gjatë përdorimit mos hani dhe mos pini lëngje e duhan. -Ruajeni në vende të sigurt, larg fëmijëve dhe ushqimeve të njerëzve e kafshëve. -Evitoni thithje e pluhurit ose tretësirës spërkatëse. -Vishni rroba mbrojtëse të përshtatshme, doreza dhe syza ose maskë për mbrojtjen e syve dhe të fytyrës. -Hiqni menjëherë rrobat e ndotura dhe i lani para se ti rivishni. -Mos rritni dozat. -Shkatërroni ambalazhet bosh sipas rregullave në fuqi.

### UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën lahuni urgjentisht me ujë të bollshëm.-Në rast se ju bie tretësirë spërkatëse në sy, i shpëlani me ujë të rrjedhshëm për 15 minuta dhe kërkoni këshillë mjekësore.-Individët që paraqesin reaksion alergjik të konsultohen me mjekun.-Në rast gëlltije mos provokoni të vjella. Dërgojeni të aksidentuarin tek mjeku dhe i tregoni atij etiketën.-Antidot specifik nuk ekziston. Për simptoma alergjike rekomandohen antihistaminikë dhe kremra me përbërje steroide ose dhe steroide sistemik. Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.

Xi



IRRITUES

Irriton sytë, lëkurën dhe sistemin e frymëmarrjes. Nga kontakti me lëkurën mund të shkaktohet alergji.

N



I RREZIKSHËM  
PËR AMBJENTIN

**HELMUES PËR PESHQIT DHE PËR ORGANIZMAT E TJERA UJORE.**

**Mos ndotni ujrën me preparatin ose me ambalazhin e tij.**

**TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.**

**PRODHUESI:** SYNGENTA Limited, Guildford,

Surrey GU2 7YH, UK.

Tel: + 44 1438 260 000, Fax: +44 1483 260 001.